



Operatori i Sistemit të Transmetimit

MIRATOHET
Administrator i OST sh.a
Klodian GRADECI



POLITIKA MJEDISORE

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a) si pjesë e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar vlerëson problemin e mbrojtjes së mjedisit si një ndër problemet e mëdha shoqërore dhe punon aktivisht për zgjidhjen e tyre. Mbrojtja e mjedisit në objektet e kompanisë sonë realizohet në disa mënyra duke përfshirë masat zbutëse dhe menaxhimin e situatave mjedisore.

Kompania jone zbaton Politikën Mjedisore të cilat sigurojnë menaxhimin mjedisor në përputhje me kërkesat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit që rrjedh prej saj për mbrojtjen e mjedisit. Ajo synon harmonizimin e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Politika Mjedisore përcakton stadet për zbatimin e gjithë elementeve të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit në OST sh.a si dhe objektivat për çështjet mjedisore, të cilat përmbushen duke zbatuar kërkesat e certifikimit sipas standardeve ISO 14001:2015.

Politika e OST-së për mjedisin mbështetet në tre shtylla kryesore:

- Menaxhimi i çështjeve mjedisore të OST-së është zhvilluar në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kërkesat mjedisore të infrastrukturave të sektorit të energjisë elektrike. OST sh.a. zbaton legjislacionin mjedisor për të gjitha projektet që në fazën e parë të projektimit, gjatë zbatimit, si dhe pas realizimit të projekteve.
- Përmirësimi i performancës mjedisore bëhet nëpërmjet sensibilizimit të përshtatshëm të stafit dhe trajnimet përkatëse për këtë çështje;
- Parandalimi dhe zbutja e ndikimeve mjedisore, duke kryer monitorimin dhe kontrollin e emetimit të gazrave në natyrë dhe ruajtja e sasisë së ndotjes brenda standardeve të pranura për të menaxhuar mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e burimeve natyrore.

Në bazë të politikave të mjedisit, menaxhimi ka caktuar objektiva mbi ndikimet mjedisore që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së kompanisë. Një bazë e fortë për menaxhimin e çështjeve mjedisore është Sistemi i Menaxhimit Mjedisor në përputhje me standardin evropian ISO 14001:2015.

Sistemi i Menaxhimit Mjedisor është një mjet menaxhimi që lejon kompanin në identifikimin dhe kontrollin e impaktit mjedisor të aktivitetit, në përmirësimin e performancën mjedisore në vazhdimësi duke zbutur efektin e mundshëm negativ në mjedis. Një qasje sistematike e menaxhimit të mjedisit mund të sigurojë menaxhimin të lartë të informacionit për përcaktimin e objektivave mjedisore dhe mënyrën si arrihen objektivat, për të krijuar mundësi në zhvillimin e qëndrueshëm.